

KUSHTET E PERGJITHSHME
TE KONTRATES PER SIGURIMIN E PARAVE NE UDHETIM – CIT

Neni 1

Dispozita te pergjithshme

- 1.1 Kushtet e Pergjithshme te kontrates per Sigurimin e Parave ne Udhetim, ketu me poshte do te quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit".
- 1.2 INTERSIG sha, ketu me poshte do te quhet "Siguruesi".
- 1.3 Personi fizik ose juridik, interesi pasuror i te cilit do te mbulohet sipas ketyre Kushteve te Sigurimit per Sigurimin e Parave ne Udhetim, ketu me poshte do te quhet shkurtimisht "I Siguruari".
- 1.4 Kontrata per Sigurimin e Parave ne Udhetim, e lidhur midis Siguruesit dhe te Siguararit, ketu me poshte do te quhet shkurtimisht "Polica e Sigurimit".

Neni 2

Objekti i sigurimit

- 2.1 Kartmonedha ne formen e valutave te ndryshme, perfshire kartmonedhen shqiptare, deri ne kufirin e permedur ne Policen e Sigurimit.
- Pasuria e siguruar mund te jete ne pronesi te te Siguararit ose e mbajtur nga i Siguruari ne cdo forme qe e ben te Siguararin pergjegjes per humbjen e saj.

Neni 3

Rreziket e siguruara

- 3.1 Siguruesi demshperblen te Siguararin per humbjen ose demtimin e pasurise se siguruar gjate udhetit nen ruajtjen e punonjesve ose nen ruajtjen e shoqerise transportuese apo siguruese, me qellim transportimin ne emer te te Siguararit.
- 3.2 Mbulimi ne sigurim sipas ketyre Kushteve te Pergjithshme do te filloje nga momenti kur punonjesi ose shoqeria transportuese apo siguruese merr ne dorezim pasurine ne emer te te Siguararit dhe do te perfundoje menjehere me dorezimin ne destinacion nga punonjesi ose shoqeria transportuese apo siguruese.
- ***Destinacioni**, këtu do të konsiderohet avioni, që ndodhet në ambientet përkatëse brenda Aeroportit "Nënë Tereza" dhe me të cilin do të kryhet transporti ndërkombëtar i vlerave.

Neni 4

Perjashtime

- 4.1 Ky sigurim do te mbuloje humbje apo demtim te pasurise vetem ne se shuma e kesaj humbje apo demtimi tejkalon shumen qe i Siguruari perfiton sipas:
- 4.1.1 kontrates se te Siguararit me shoqerine transportuese apo siguruese;
- 4.1.2 mbulimit ne sigurim te kesaj shoqerie transportuese apo siguruese ndaj klienteve te saj;
- 4.1.3 cdo lloj tjeter mbulimi ne sigurim dhe demshperblimi ne fuqi ne cdo lloj forme te kryer nga apo ne perfitim te klienteve te kesaj shoqerie transportuese apo siguruese;
- dhe ne kete rast ky sigurim do te mbuloje vetem pjesen e shumes qe tejkalon kufijte e siperpermendur.
- 4.2 Sigurimi CIT nuk mbulon demet qe shkaktohen drejtperdrejt apo indirekt prej:
- 4.2.1 zhdukjeve misterioze;
- 4.2.2 mashtrimit dhe jobesueshmerise se punonjesve;
- 4.3 Sigurimi CIT nuk mbulon demet qe shkaktohen drejtperdrejt apo indirekt prej grevave, kryengritjeve, trazirave dhe turbullirave civile, luftes, pushtimit, invazionit, veprimeve te armiqve te huaj, veprimeve luftarake (pavaresisht ne se eshte shpallur lufte ose jo), luftes civile, rebelimeve, revolucionit, kryengritjeve, fuqive ushtarake apo pushtuese, konfiskimeve ose shtetezimeve ose rekuizimeve ose shkaterrimeve te pasurise nga apo ne baze te urdherave te cdo qeverie ose autoriteti publik ose lokal;

4.4 Ky sigurim nuk do te mbuloje humbje apo demtim te pasurise ardhur si pasoje e direkte apo indirekte apo e ndikuar nga:

4.4.1 rrezatimi jonizues ose ndotjes radioaktive nga lende berthamore ose rezerve berthamore ose nga shperthimi i lendeve berthamore;

4.4.2 lendeve radioaktive, helmuese, shperthyese ose lende te tjera te rrezikshme apo ndotese te instalimeve berthamore, reaktoreve berthamore apo njesive te tjera berthamore ose elementeve berthamore;

4.4.3 cdo arme lufte qe shfrytezohet zberthimin dhe/ose bashkimin berthamor apo te ngjashme me to.

Neni 5

Tarifa e primit te sigurimit

5.1 Tarifa do te caktohet ne baze te shumes se sigurimit, masave mbrojtese dhe kushteve te transportit. Tarifa do te caktohet vecanerisht per cdo Police Sigurimi.

Neni 6

Primi i sigurimit

6.1 Primi i sigurimit llogaritet duke shumezuar tarifen e primit te sigurimit me shumen e siguruar.

6.2 Primi i sigurimit mund te paguhet teresisht ose me keste, sipas ketyre rregullave:

6.2.1 kur periudha e sigurimit eshte nen 1 vit, si rregull, primi i sigurimit do te paguhet njeheresh;

6.2.2 kur periudha e sigurimit eshte 1 vit, si rregull, primi i sigurimit do te paguhet me dy keste.

6.3 Ne rastin e pageses se primit te sigurimit me dy keste, data e pageses se keshtit te dyte do te caktohet jo me vone se kater muaj nga data e pageses se keshtit te pare, sipas percaktimit ne Policen e Sigurimit.

6.4 Rregullimi perfundimtar i mases se primit do te behet me perfundimin e periudhes se sigurimit ne formen dhe menytrat e percaktuara ne Policen e Sigurimit.

6.5 Pagesa e primit ose keshteve te tij, behet prane deges ose agjencise se Siguruesit ku eshte leshuar Polica e Sigurimit.

Pagesa do te quhet e kryer ne momentin e kalimit te shumes se caktuar ne llogarine bankare te Siguruesit.

6.6 Primi i sigurimit paguhet ne monedhen e percaktuar ne Policen e Sigurimit.

Neni 7

Pjesa e zbritshme

7.1 Ne rastet e ndodhjes se cdo nje ngjarje sigurimi, do te zbatohet pjese e zbritshme.

7.2 Pjesa e zbritshme do te citohet ne Policen e Sigurimit

7.3 Siguruesi nuk pergjigjet per pjesen e zbritshme te percaktuar ne Policen e Sigurimit e cila mbartet nga vete i siguruari

Neni 8

Polica e sigurimit

8.1 Polica e Sigurimit lidhet ne baze te kerkeses me shkrim te te Siguruarit.

Siguruesi leshon Policen e Sigurimit dhe percakton primin e sigurimit ne baze te njoftimeve dhe deklarimeve te bera nga i Siguruari. Kerkesat dhe njoftimet e deklarimet e tjera te te Siguruarit i bashkengjiten Polices se Sigurimit.

8.2 I Siguruari, me nenshkrimin e Polices se Sigurimit, eshte pergjegjes lidhur me saktesine dhe vertetesine e njoftimeve e deklarimeve te bera prej tij.

8.3 Siguruesi ka te drejte te verifikojte vertetesine e njoftimeve e deklarimeve te te Siguruarit e te kryeje inspektime per saktesim te dhenash.

8.4 Polica e Sigurimit mund te perfundoje ne cdo kohe nga i Siguruari duke i drejtuar kerkesa me shkrim Siguruesit. Ne kete rast Siguruesi ka te drejte te mbaje ose marre pjesen e primit ne perpjestim me kohezgjatjen e Polices se Sigurimit.

8.5 Polica e Sigurimit mund te zgjidhet nga Siguruesi duke lajmeruar 30 dite me pare me shkrim te Siguruarin. Ne kete rast, Siguruesi do te mbaje ose marre pjesen e primit ne perpjestim me demshperblimin e paguar dhe kohezgjatjen e Polices se Sigurimit.

8.6 Polica e Sigurimit mbetet ne fuqi per nje afat 15 ditor dhe pas dites se fillimit te detyrimit per pagimin e kestit te dyte te primit te sigurimit.

8.7 Mospagimi i kestit te dyte te primit te sigurimit sjell pasojat e meposhtme:

8.7.1 Siguruesi ka te drejte te zgjidhe Policen e Sigurimit;

8.7.2 demshperblimin e reduktuar ne masen 50 per qind per humbjet dhe demtimet e vertetuara perpara perfundimit te afatit te mbulimit ne sigurim sipas kestit te pare te primit te sigurimit;

8.7.3 kthimin nga i Siguruari te demshperblimeve te paguara ne masen 50 per qind per cdo humbje e demtim te vertetuar perpara perfundimit te afatit te mbulimit ne sigurim sipas kestit te pare te primit te sigurimit.

8.8 Kushtet e percaktuara ne Policen e Sigurimit nuk mund te ndryshohen,pervecse me shtojce qe eshte pjese e Polices nenshkruar nga punonjesi i Siguruesit.

8.9 Duke pranuar Polices e Sigurimit, i Siguruari pranon se Polica perfshin te gjitha marreveshjet ekzistuese ndermjet te Siguruarit dhe Siguruesit ose Agjenteve te tij ne lidhje me kete mbulim ne sigurim.

Neni 9

Periudha e sigurimit

9.1 Periudha e Sigurimit, si rregull, eshte 1 vit, pervec rasteve kur ne Policen e Sigurimit percaktohet ndryshe, por jo me pak se tre muaj.

9.2 Sigurimi fillon nga ora 24 e dites se percaktuar ne Policen e Sigurimit, me kusht qe te jete paguar me pare primi i sigurimit ose kesti i tij i pare.

Neni 10

Detyrime

10.1 I Siguruari detyrohet:

10.1.1 te zbatoje masat e rregullat e sigurimit te percaktuara ne menyre specifike ne Policen e Sigurimit dhe te tregojte perkujdesjen e duhur per parandalimin e demit;

10.1.2 te regjistroje pasurine e siguruar sipas dispozitave ligjore ne fuqi dhe ne menyre te tille qe Siguruesi te mund te percaktojte me sakte shumen e siguruar dhe masen e humbjes.

Neni 11

Ngjarja e sigurimit

11.1 Eshte kusht paresor per pergjegjesine e Siguruesit qe per cdo ngjarje qe mund te jete shkak per kerkese demshperblimi, i Siguruari menjehere duhet:

11.1.1 te informoje menjehere organet perkatese te Rendit dhe t'u jape atyre te gjitha ndihmen e nevojshme per identifikimin dhe kapjen e personit(nave) pergjegjes dhe gjetjen e pasurise se vjedhur;

11.1.2 te njoftoje me shkrim Siguruesin;

11.1.3 t'i jape Siguruesit te gjitha informacionin dhe ndihmen e kerkuar.

11.2 Ne rast se i Siguruari deklaroi kerkese per demshperblim duke e ditur se eshte e pavertete ose mashtruese, per sa i perket shumave ose cdo elementi tjeter, mbulimi ne sigurim pushon se ekzistuar dhe te gjitha kerkesat per demshperblim anulohen.

Neni 12

Ekspertimi

12.1 Siguruesi brenda 10 diteve nga njoftimi i te Siguruarit duhet te filloje ekspertimin e demit te ndodhur.

12.2 Ne rastet kur i Siguruari nuk pranon pjeserisht apo plotesisht aktekspertimin e Siguruesit, e njofton ate me shkrim brenda 3 diteve nga marrja e ketij akti.

Lidhur me mosmarreveshjen, te dyja palet caktojne nje ekspert tjeter ose nje grup ekspertesh te perbere nga perfaqesues te tyre ose te trete.

Eksperti ose grupi i eksperteve te lartpermendur nuk kane te drejte te riekspertojne apo te vazhdojne riekspertimin e filluar kur vertetohen demtime te tjera te pasurise se siguruar. Ne keto kushte, procedura e ekspertimit do te rifillonte sipas nenit me siper.

12.3 Ekspertet duhet:

12.3.1 te verifikojne dhe sqarojne rrethanat e ngjarjes;

12.3.2 te verifikojne sakesine e deklarave apo pershkrimeve qe rezultojne nga aktet kontraktore dhe te percaktojne ne se ne momentin e demtimit ekzistonin rrethana qe kishin ndryshuar rrezikun dhe nuk ishin komunikuar;

12.3.3 te verifikojne ne se i Siguruari ka plotesuar detyrimet e tij;

12.3.4 te kryejne vleresimin e demit, konform Kushteve te Sigurimit dhe Polices se Sigurimit.

Neni 13**Kerkesa per demshperblim**

13.1 I Siguruari, per marrjen e demshperblimit, i paraqet Siguruesit kerkesa me shkrim sipas formularit te furnizuar nga Siguruesi.

13.2 Siguruesi paguan demshperblimin pasi ka marre akt-ekspertimin perfundimtar dhe vetem ne qofte se i paraqitet kerkesa me shkrim nga i Siguruari.

Neni 14**Demshperblimi**

14.1 Siguruesi paguan ose refuzon pagimin e demshperblimit brenda 30 diteve nga ajo e marrjes se kerkeses per demshperblim.

Fillimi i afatit pezullohet per aq kohe sa demshperblimi nuk mund te paguhet ose percaktohet per shkak te te metave qe ka i Siguruari.

14.2 Siguruesi mund te shtyje pagesen e demshperblimit:

14.2.1 per aq kohe sa ekzistojne dyshimet mbi te drejten e te Siguruarit per te marre pagesen;

14.2.2 ne qofte se eshte filluar ceshtja penale lidhur me ngjarjen e sigurimit ndaj te Siguruarit ose njerit prej punonjesve te tij deri ne perfundimin e nje procedure te tille.

14.2.3 Siguruesi pergjigjet per demet qe vertetohen gjate periudhes se mbulimit ne sigurim, por shuma e pergjithshme e demshperblimeve nuk mund te jete me e larte se shuma e siguruar e treguar ne Policen e Sigurimit.

14.2.4 Ky sigurim nuk do te demshperbleje deme per te cilat i Siguruari perfiton demshperblim nen kontrata te tjera.

Ben perjashtim pjesa e demit qe tejkalon shumen qe do te ishte mbuluar nen kontratat e tjera ne rastin kur Polica e percaktuar nga keto Kushte Sigurimi te mos ishte ne fuqi.

14.2.5 Ne rast pagese demi sipas kesaj Police, Siguruesi do te kete te drejte te perfitoje te drejten e te Siguruarit per te kerkuar kthimin e te drejtave pasurore ose cdo te drejte tjeter legale ndaj cdo personi ose organizate.

I Siguruari do te veproje me te gjitha menyrat e duhura per te siguruar keto te drejta.

I Siguruari nuk do te beje asnje veprim per te paragjykuar keto te drejta.

Neni 15**Shkrirja ose ndryshimi i pronesise ose kontrollit te veprimtarise ekonomike**

15.1 Polica e Sigurimit, leshuar ne baze te ketyre Kushteve te Sigurimit, do te pushoje menjehere cdo lloj mbulimi ne sigurim ne rast te likuidimit (vullnetar ose te detyrueshem) te te Siguruarit, ose futjes ne marreveshje te tilla.

15.2 I Siguruari do te lajmeroje menjehere Siguruesin per:

15.2.1 cdo bashkim ose shkrirje me veprimtari te tjera ekonomike ose cdo blerje, dhenie, transferim, lenie peng apo shitje te pasurive apo aksioneve qe shkaktojne ndryshime ne pronesine ose kontrollin, financiar ose tjeter, te veprimtarise ekonomike;

15.2.2 heqjen e kontrollit të Siguruarit mbi veprimtarinë ekonomike nga cdo Qeveri apo zyrtar i caktuar nga cdo Qeveri apo Autoritet Lokal.

15.3 Kusht për vazhdimin e mbulimit në sigurim është që i Siguruari t'i japë menjëherë Siguruesit informacionin që Siguruesi do të kërkojë dhe i Siguruari të paguajë primin shtesë sic mund të kërkojë Siguruesi si rrjedhojë e këtij ndryshimi.

Neni 16

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

16.1 Për cdo mosmarreveshje që nuk zgjidhet me mirekuptim, palet do t'i drejtohen Gjykatës së vendit ku është leshuar Polica e Sigurimit.

Klauzola e sanksioneve:

“(Ri)Siguruesi nuk do të ofrojë mbulim dhe nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë dëm apo të japë ndonjë përfitim të parashikuar në këtë kontratë, në atë masë që sigurimi i një mbulimi të tillë, pagesa e një dëmi të tillë ose sigurimi i një përfitimi të tillë do ta ekspozojnë (ri)Siguruesin ndaj ndonjë sanksioni, ndalimi ose kufizimi sipas rezolutave të Kombeve të Bashkuara apo sanksioneve tregtare ose ekonomike, legjislacionit të Bashkimit Evropian, Shqipërisë, Mbretërisë së Bashkuar ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës (me kusht që kjo nuk bie në kundërshtim me ndonjë rregullore ose ligj lokal specifik të zbatueshëm për (ri)siguruesin).”